

 <p>Universiteti i Prizrenit Univerzitet Prizrena Prizren Universitesi "UKSHIN HOTI" FAKULTETI JURIDIK</p>	
Pranuar më dt. 05.02.2024	
Zyra e pranimit 410	Nr. i protokolit 03/65



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
Fakulteti Juridik/Faculty of Law



Universiteti Tiranës
Fakulteti i Drejtësisë

Me synimin për të forcuar bashkëpunimin në fushën e shkencës, teknologjisë dhe arsimit, duke pranuar rëndësinë e partneritetit të bazuar në parimet e pjesëmarrjes vullnetare, barazisë, të mirës së përbashkët dhe reciprocitetit, në varësi të disponueshmërisë së burimeve të ofruara për të përmbushur bashkëpunimin ndërmjet Palëve, lidhet:

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI PËR SHKENCË DHE ARSIM

NDËRMJET

FAKULTETIT JURIDIK, UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
KOSOVË,

DHE

FAKULTETIT TË DREJTËSISË, UNIVERSITETI I TIRANËS, SHQIPËRI

Neni 1
Palët

1. Palët në këtë Marrëveshje bashkëpunimi janë:
 - a) **Fakulteti Juridik, Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren (UUHP)**, me seli në Rr. Shkronjat 1, 20000 Prizren, Kosovë, i përfaqësuar nga Dekani, Prof. Asoc. Dr. Muharem Faiku
 - b) **Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Tiranës (UT)**, me seli në 8R88+VC5, Rruga Milto Tutulani, 1010, Shqipëri, i përfaqësuar nga Dekanja, Prof. Asoc. Dr. Dorina Hoxha.
2. Palëve që janë pjesë e këtij memorandumi të bashkëpunimit, i referohemi si "palët", kurse këtij memorandumi, si "memorandum".

Neni 2

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i këtij memorandumi është zhvillimi i bashkëpunimit akademik në nivelin e studimeve universitare, si dhe zhvillimin e aktiviteteve kërkimore, shkencore dhe të kontributit në komunitet ndërmjet dy palëve.
2. Fushëveprimi i këtij memorandumi ndërlidhet me zbatimin e qëllimit të tij dhe përfshin:
 - a) Krijimi i kornizës për bashkëpunim në fushën e shkencave juridike ndërmjet Palëve;
 - b) Krijimin e mundësive për shkëmbim të stafit akademik të Fakultetit dhe studentëve;
 - c) Gjenerimin dhe ndarjen e njohurive të reja dhe zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve inovative në fushën e shkencës dhe arsimit, në varësi të burimeve të disponueshme për Palët;

Neni 3

Parimet

1. Bashkëpunimi në këtë memorandum do të mbështetet mbi bazën e parimeve demokratike dhe në pajtim me lirinë akademike të palëve, duke marrë në shqyrtim nevojat e përbashkëta gjatë bashkëpunimit të tyre me qëllim të përfitimit gjatë zhvillimit dhe shkëmbimeve shkencore, edukative dhe të kontributit në komunitet.
2. Zbatimi i këtij memorandumi të bashkëpunimit ka parasysh:
 - a) Lirinë akademike,
 - b) Zhvillimin dhe promovimin e dijes,
 - c) Rritja e vazhdueshme e cilësisë,
 - d) Ndërkombëtarizimin e programeve të përbashkëta,
3. Palët pajtohen që obligimet dhe të drejtat që dalin nga kjo marrëveshje të zbatohen duke u bazuar në Ligjet e zbatueshme dhe Statutet e palëve të kësaj marrëveshje.

Neni 4

Fushat e bashkëpunimit

1. Fushat kryesore të bashkëpunimit sipas këtij memorandumi përfshijnë, por nuk kufizohen në fushat e mëposhtme:
 - a) Shkëmbimi i informacionit rreth strategjive dhe programeve të Palëve në fushën e shkencave juridike.
 - b) Shkëmbime të stafit akademik për mbulimin e programeve të studimit në nivelin bachelor dhe master;

- c) Shkëmbime të stafit akademik për mbulimin e lëndëve të caktuara për programin master “Qeverisje Demokratike dhe Sundim i Ligjit” në Fakultetin Juridik, Univeristeti “Ukshin Hoti” Prizren¹;
- d) Vizita studimore të stafit akademik të Fakultetit dhe studentëve;
- e) Aplikimi i Sistemit Evropian të Transferimit dhe Akumulimit të Kredive (ECTS) për shkëmbim të studentëve dhe njohjen e aktiviteteve arsimore të kryera në të dy vendet;
- f) Shkëmbimi i materialeve dhe botimeve shkencore dhe mësimore;
- g) Promovimi i bashkëpunimit në fushat e mësimdhënies dhe kërkimit;
- h) Zhvillimi i programeve të cilat janë reciprokisht të dobishme për të dyja palët;
- i) Diskutimi i fushave të tjera me interes të përbashkët, duke përfshirë mundësinë e eksplorimit të programeve të përbashkëta, marrëveshjeve të shkallës së dyfishtë dhe qendrave të ekselencës;
- j) Mentorim / komentorim të temave të doktoratës;
- k) Kërkim dhe zhvillim bashkëpunues me përfitim reciprok. Çdo publikim që rezulton nga hulumtimi bashkëpunues do të mbajë emrat e anëtarëve të ekipit nga të dy institucionet.

Neni 5 Zbatimi

1. Për të gjitha veprimet në përmbushjen e këtij memorandumi, palët do të përmbushin obligimet financiare sipas në përputhje me aktet e brendshme për angazhimin e stafit akademik sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit.
2. Me qëllim të zbatimit të këtij memorandumi palët garantojnë një bashkëpunim dhe komunikim efektiv, përmes nënshkruesve drejtpërdrejtë ose përmes personave përgjegjës që caktohen nga nënshkruesit e këtij memorandumi.
3. Palët njoftojnë me shkrim njëra tjetrën për çështjet që janë pjesë e zbatimit të këtij memorandumi, përmes kërkesave ose një plani konkret paraprak të përgatitur.
4. Me qëllim të zbatimit të këtij memorandumi palët mbajnë kontakte të rregullta, përmes personave përgjegjës të caktuar paraprakisht dhe të ngarkuar për zbatimin e këtij memorandumi

Neni 6 Kontrolli i të drejtave të pronësisë intelektuale

1. Palët garantojnë mbrojtjen e duhur dhe efektive dhe shpërndarjen e barabartë të të drejtave mbi pronësinë intelektuale që mund të lindin si rezultat i bashkëpunimit të përbashkët në kuadrin e këtij memorandumi sipas ligjeve kombëtare dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të vendeve të cilave Palët bëjnë pjesë.

¹ Vlen të theksohet se ky program është në procesin e akreditimit.

2. Kushtet e blerjes, ruajtjes dhe përdorimit të të drejtave të pronësisë intelektuale në lidhje me produktet dhe (ose) proceset e mundshme që mund të jenë rezultat i këtij memorandumi duhet të jenë objekt i marrëveshjeve shtesë dhe programeve të punës në kuadër të bashkëpunimit.

Neni 7 Mirëbesimi

1. Palët pajtohen që ky memorandum të zbatohet në mirëbesim profesional, duke iu përgjigjur obligimeve konkrete.

Neni 8 Afati dhe hyrja në fuqi

1. Memorandumi ka vlefshmëri të pakufizuar, përpos nëse palët merren vesh ndryshe me shkrim.
2. Memorandumi mund të përfundoj me kërkesën me shkrim nga cilado prej palëve nënshkruese, me një paralajmërim prej së paku 30 ditëve.
3. Përmbajtja e këtij memorandumi mund të ndryshohet me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet Palëve.
4. Palët do të angazhohen për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi përmes negociatave të drejtpërdrejta.
5. Ky memorandum është nënshkruar në gjashtë (2) kopje identike në Gjuhën Shqipe.

Palët nënshkruese:

Për: Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Prof. Asoc. Dr. Dorina Hoxha, Dekane

Për: Fakultetin Juridik të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren

Prof. Asoc. Dr. Muharrem Fajku, Dekan

